



A.nr.614/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.346/2022 të datës 08.04.2024 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.510/2024 të datës 07.05.2026 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.1018/2021, të datës 07.12.2021, të parashtruar nga ankuesi Xh.G, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat H.S nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike *“Kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1018/2021, e datës 07.12.2021, e parashtruar nga ankuesi Xh.G.

A r s y e t i m

Ankuesi Xh.G (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 07.12.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Grada dhe Disiplin në lidhje me kërkesën e datës 08.09.2021 dhe kërkesës së datës 02.09.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.12.2021, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me provat ndërlidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.02.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.1018/2021, me të cilin ka hedhur poshtë si të jashtëafatshme ankesën e ankuesit të datës 07.12.2021.

Ankuesi kundër këtij vendimi ka hapur konflikt administrativ, pranë gjykatës kompetente, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.346/2022, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar vendimin e kontestuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit AA.nr.510/2024 ka refuzuar ankesën duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë në këtë lëndë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5856/2021 të datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.12.2021; Vendimin me Nr. Ref:88/2017 i datës 02.03.2017; Vendimin me Nr. 188/2021 i datës 01.10.2021 për ndërprerjen e pushimit pa pagesë; Emailin e ankuesit për Departamentin për Çështje Ligjore; Emailin e datës 13.08.2021 nga A.P për ankuesin; Emailin e datës 13.10.2021 nga ankuesi për K.D; Emailin e datës 31.08.2021 nga Zyra e Sekretarit në MPJD për shpalljen e pozitave vakante në misione diplomatike apo poste konsullore; Shprehjen e interesit të ankuesit të datës 02.09.2021; Emailin e datës 13.10.2021 nga ankuesi për Zyrën e Sekretarit të MPJD; Emailin e datës 03.09.2021 për shpalljen e interesimit për gradim; Kërkesën për gradim gjegjësisht ngritje të gradës diplomatike të datës 08.09.2021 nga ankuesi; Formularin e vlerësimit për ankuesin datës 29.10.2019 dhe datës 23.10.2018; CV-në e ankuesit; Letër motivuese nga ankuesi; Certifikatën me Nrt.76 e ankuesit; Certifikatën shtator 2017; Përgjigjen në ankesë të datës 21.12.2021; Akt Emërimit AE.Nr.25/2021 të datës 07.04.2021; Vendimin për sistemim të përhershëm i datës 02.04.2021; Vendimin me Nr. Ref:1115/2021 të datës 16.02.2021; Vendimin për lejimin e pushimit pa pagesë për ankuesin datë 03.06.2021; Vendimin A.nr.1018/2021 të KPMSHCK-së; Aktgjykimin A.nr.346/2022 të datës 08.04.2024 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.510/2024 të datës 07.05.2026 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas akt emërimit AE.Nr.25/2021 të datës 07.04.2021 mban pozitën *Zyrtar i Lartë për Logjistikë* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa sipas Vendimit me Nr. Ref:116/2021 të datës 09.06.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i është lejuar pushimi pa pagesë nga data 01.06.2021 deri më datë 01.06.2022, kurse pushimi pa pagesë i është ndërprere prej datës 04.10.2021 sipas Vendimit me Nr. 188/2021 të datës 01.10.2021.

Ankuesi i është drejtuar me kërkesë Departamentit për Çështje Ligjore se meqë është në pushim pa pagesë ka të drejtë të aplikoj për ngritje të gradës diplomatike dhe a kam të drejtë për shprehje të interesimit apo aplikim për shkuarje në mision diplomatik edhe pse jam në pushim pa pagesë, ndërsa zyrtarja e këtij departamenti përmes emailit të datës 13.08.2021 ka njoftuar ankuesin se sipas nenit 14 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përcaktohet: “Për kohën e

mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1 i këtij neni, zyrtarit publikë i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave për rikthim në vendin e tij të punës''.

Më datë 31.08.2021, nga Zyra e Sekretarit të MPJD, nëpunësit e kësaj ministri janë njoftuar për shpallje të pozitive vakante në Misionet diplomatike për poste konsullore të Republikës së Kosovës, ku afati për aplikim ka qenë nga data 31.08.2021 deri më datë 05.09.2021, ndërsa me datë 03.09.2021 nga Zyra e Sekretarit të MPJD, të punësuarit në këtë ministri janë njoftuar për shpalljen e shprehjes së interesit për gradim e ku kërkesat mund të parashtrihen te Komisioni për Grada dhe Disiplinë prej datës 03.09.2021 deri më datë 08.09.2021.

Ankuesi më datë 02.09.2021 i është drejtuar me kërkesë Kryesuesit të Komisionit, me të cilin ka shprehur interesimin për pozitën vakante në misionet diplomatike/konsullore, duke shprehur preferencë për tri misionet diplomatike/konsullore në SHBA (IOVA), Australi (KAMBERA), ndërsa më datë 08.09.2021 ka parashtruar kërkesë te Komisioni për Grada dhe Disiplinë për gradim, gjegjësisht ngritje të gradës diplomatike, mirëpo që nuk ka marrë përgjigje nëse kërkesa e tij është shqyrtuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nga emaili me të cilin i është referuar Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ka lënë të nënkuptohet se ankuesi nuk ka të drejtë për shprehjeje të interesit, mirëpo ky konstatim nuk është dhe nuk duhet të jetë relevante sepse është përdorur nga institucioni si interpretim ekstenziv duke i dhënë kësaj norme mundësi që të keqpërdoret si në rastin e ankuesit, pra nga ky interpretim mungesa në punë pa pagesë është trajtuar si përfundim i marrëdhënies së punës e kjo nuk mund të konsiderohet si e tillë. Me këtë interpretim të një akti nënligjor kemi të bëjmë me shkelje e pastër e ligjit për shkak që i është mohuar e drejta për avancim dhe ngritje profesionale. Pra mos shqyrtimi i kërkesave dhe mohimi i të drejtës për avancim dhe ngritje profesionale është shkelje e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Kërkon që të aprovohet ankesa, të pezullohet procedura e shpallur me njoftimin e datës 31.08.2021 për pozitën vakante në misionet diplomatike apo poste konsullore si dhe procedura e shpallur me njoftimin e datës 03.09.2021, të obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisionet e caktuara në MPJD që ankuesin ta përfshijnë në listën e ngushtë sipas kërkesës së datës 02.09.2021.

Kolegji i Këshillit lidhur statusin e të punësuarve të administratës në MPJD, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm nga muaji korrik 2020 deri në muajin shtator 2023), gjegjësisht me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2, përcaktohet: “1.Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”.

Pra sipas këtyre dispozitave nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimit konsullor kishin statusin e nëpunësit civil me status të veçantë, por Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës çështjet e parapara me paragrafin 2 të nenit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk i kishte rregulluar me akte të veçanta me qëllimin që të njëjtat të aplikohen për rastet konkrete, dhe duke qenë se nuk i ka pasur të rregulluara, atëherë në këtë rast aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Kolegji i Këshillit sipas provave të prezantuara si më lartë, konstaton faktin e pakontestueshëm se ankuesi nga data 01.06.2021 deri më datë 04.10.2021 ka qenë në pushim pa pagesë, pra duke qenë se pushimi pa pagesë ankuesit i është lejuar për përkujdesje shëndetësore ndaj fëmijut, sipas legjislacionit të aplikueshëm në kohë, respektivisht sipas nenit 57 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ky ishte në pezullim vullnetar të marrëdhënies së punës, ndërsa sipas nenit 14 paragrafi 4 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përcaktohet: *“Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1 i këtij neni, zyrtarit publikë i pushojë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave për rikthim në vendin e tij të punës”*, pra sipas kësaj norme juridike nëpunësi që ka qenë në pushim pa pagesë i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, por kjo nuk nënkupton asesi përfundim i marrëdhënies së punës siç ankuesi pretendon në ankesën e tij.

Kolegji i Këshillit, sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në kohë, konstaton se ankuesi nuk ka pasur të drejtë të aplikoj për shprehje interesimit për pozitat vakante në misione diplomatike/konsullore, për shkak që i njëjti ka qenë në pushim pa pagesë, dhe sipas dispozitave të cekura më lartë gjatë kohës së pushimit pa pagesë i kanë pushuar të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënies e tij e punës, pra i ka pushuar çdo e drejtë që është paraparë me ligji deri në përfundimin e pushimit pa pagesë, e për rrjedhojë në këtë rast Kolegji i Këshillit, vlerëson se me rastin konkret ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, pra nuk i është mohuar asnjë e drejtë, pra nuk kemi shkelje të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme dhe nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.614/2024, datë 17/06/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Avokat H.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD;
- Arkivit të KPMSHCK-së.